

Vendim nr. 45 datë 28.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.02.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 35 (B) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: BASHKIM RUSI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 2294 (80-2022-2343), datë 13.09.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42 pika 2 dhe neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 50 pika 4, 71 pika 1 dhe 71/a, pika 1/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000)

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 13.05.2022 Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë nëpërmjet procesverbalit të konstatimit të shkeljes nr. 2205130, datë 13.05.2022, ka gjobitur për mosrespektim të sinjalizimit rrugor mjetin tip Opel me targa AA932UR. Mjeti rezulton në emër të kërkuarit dhe masa administrative e vënë është në vlerën 2000 lekë. Kërkuar nuk ka qenë prezent në momentin e gjobitjes.

2. Ai ka ardhur në dijeni të këtij fakti pasi ka klikuar sistemin elektronik të gjobave në faqen e Policisë së Shtetit, në datën 03.06.2022 dhe po në këtë datë i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Policisë Rrugore për t'u pajisur me procesverbalin e shkeljes. Me shkresën nr. prot. 13-18/1, datë 21.06.2022, Drejtoria e Policisë Rrugore i ka vënë në dispozicion kërkuarit procesverbalin. Më pas kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt, “Konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit të datës 13.05.2022.”.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2294 (80-2022-2343), datë 13.09.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

4. Në datën 23.12.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 2294(80- 2022-2343), datë 13.09.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

II

Pretendimet e kërkuarit

5. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se i janë cenuar:

5.1. *Parimet e sigurisë juridike dhe disponibilitetit*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka gjykuar përtej objektit të padisë. Kërkuari ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit të shkeljes dhe jo shfuqizimin e tij siç shprehet gjykata. Këta janë dy terma krejtësisht të ndryshëm. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka ndryshuar bazën ligjore të padisë, duke gjykuar jashtë objektit të padisë, pa pasur një kërkesë nga palët në proces.

5.2. *E drejta e ankimit*, për shkak të disponimit të gjykatës së shkallës së parë për mosankimin e vendimit në një gjykatë më të lartë.

5.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka arsyetuar për kërkimin e tij sipas objektit të padisë. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk është shprehur për kërkesën e tij në lidhje me pretendimet abuzive të paraqitura nga pala e paditur.

5.4. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka marrë në shqyrtim prova të pavlefshme, konkretisht regjistrin për njoftimin e gjobave, por në asnjë moment nuk u provua se kishte një procesverbal të mbajtur në mënyrë ligjore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

7. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

8. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke parashtruar formalisht përpara saj pretendimet e tij. Bazuar në nenin 45, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji*

nr. 49/2012), ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim dhe është i formës së prerë. Për rrjedhojë, ai e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 23.12.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), ndërsa vendimi gjyqësor që kundërshtohet prej tij është dhënë në datën 13.09.2022. Për pasojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit të lartpërmendur.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas jurisprudencës kushtetuese kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, kërkuesi, ndër të tjera, pretendon cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe disponibilitetit, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka gjykuar përtej objektit të padisë. Ai pretendon se në kërkesëpadi ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së procesverbalit të shkeljes dhe jo shfuqizimin e tij siç shprehet gjykata, të cilët sipas tij janë dy terma krejtësisht të ndryshëm. Gjithashtu, ai pretendon se është cenuar edhe e drejta e ankimit, për shkak të disponimit të gjykatës së shkallës së parë për mosankimin e vendimit në një gjykatë më të lartë.

14. Për sa i përket pretendimit të kërkuetit për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe disponibilitetit, Kolegji konstaton se ai nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues në mbështetje të këtij pretendimi. Argumentet e tij kanë të bëjnë me terminologjinë e përdorur nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë. Referuar vendimit gjyqësor objekt kërkesë, konstatohet se objekti i kërkesëpadi së kërkuetit ka qenë pavlefshmëria e procesverbalit të shkeljes dhe Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë, në arsyetimin e vendimit të saj ka trajtuar pikërisht institutin e pavlefshmërisë së akteve administrative. Në përfundim të gjyqimit ka vlerësuar se akti administrativ, procesverbali i shkeljes, është i

ligjshëm. Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

15. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së ankimit, Kolegji vëren se në kundërshtim me sa pretendohet nga kërkuesi, e drejta e ankimit nuk është kufizuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, por nga neni 45 i ligjit nr. 49/2012, për të cilin kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

16. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me cenimin e standardit të arsyetimit dhe parimin e barazisë së armëve, Kolegji konstaton se ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

17. Kërkuesi pretendon se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka arsyetuar për kërkimin e tij sipas objektit të padisë. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk është shprehur në lidhje me kërkesën e tij për pretendimet abuzive të paraqitura nga pala e paditur.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përmban të dhënat e palëve, shkaqet e ngritura në kërkesëpadi, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Ai nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në

përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Gjithashtu, Kolegji konstaton se Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në kërkesëpadi nga kërkuesi, duke u dhënë përgjigje atyre në thelb. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se ai i përmbush standardet vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit dhe, për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

20. Kërkuesi pretendon cenimin e këtij parimi për shkak se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka marrë në shqyrtim prova të pavlefshme, konkretisht regjistrin për njoftimin e gjobave, por në asnjë moment nuk u provua se kishte një procesverbal të mbajtur në mënyrë ligjore.

21. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr.9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, në rastin konkret rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka marrë në shqyrtim një sërë provash, ndër të cilat edhe procesverbali i shkeljes, i cili sipas asaj gjykate është mbajtur sipas parashikimeve ligjore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në asnjë moment nuk i është referuar regjistrin për njoftimin e gjobave, siç pretendon kërkuesi. Gjithashtu, nuk rezulton që ai të jetë vënë në pozita të pabarabarta me palën paditëse. Atij i është dhënë mundësia që gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të kundërshtojë procesverbalin e shkeljes së datës 13.05.2022, të debatojë në lidhje me të, si dhe të paraqesë argumente dhe prova në

mbështetje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon që edhe ky pretendim i kërkuarit është i haptazi pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.